



ZHVILLIMI HARMONIK I ÇDO FËMIJE



TË DREJTAT E FËMIJËVE

ERMIR (11), BLEND A (12), ELION (12), VESEL (11), RREZON (11), ADENESA (11), ERZA (12),
FATLIND(11), ERMA (11)



Lexues të dashur, më poshtë do të shihni një tekst shumë interesant për demokracinë dhe të drejtat e fëmijëve. Këto informata janë shkruar nga nxënësit e klasës së VI-1 dhe VI-2 nga shkolla fillore „Sadri Misini“

Fëmijët kanë të drejtat e tyre të barabarta dhe ato janë: e drejta për jetesë, e drejta për emër, për shkollim, e drejta për shprehje, e drejta për mësim, e drejta për të lëvizur, e drejta për të folur, e drejta për t'u argëtuar dhe gjithashtu fëmijët kanë të drejtën për shoqërim me të tjerët.

Personat deri në moshën 18 vjeçare nuk kanë të drejtë pune, sepse është e ndaluar me ligj. Fëmijët duhet të presin derisa t'i mbushin 18 vjet dhe atëherë kanë të drejtë të votojnë. Mirëpo, fëmijët duhet gjithmonë të kenë respekt ndaj të rriturve, ndaj të moshuarve, por edhe ndaj të panjohurve.

Kurrsesi, nuk duhet të ketë dhunë ndaj fëmijëve. Ata kanë të drejtat e barabarta, pa marrë parasysh racën, gjininë, as kombin e tyre. Ndërsa tema tjetër që ne sot kemi mësuar është demokracia. Fjala demokraci rrjedh nga gjuha greke, që do të thotë „demos“ popull dhe „kratos“ pushtet. Ajo është një formë e qeverisjes, në të cilën shumica e njerëzve ushtrojnë sovranitetin e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë përmes referendumeve, ose në mënyrë jo të drejtpërdrejtë përmes zgjedhjes së përfaqësuesve.

Format më të njohura të demokracisë janë: demokracia e drejtpërdrejtë dhe demokracia përfaqësuese. Demokracia përfaqësuese ndahet në sistemin parlamentar dhe sistemin presidencial.

Disa nga elementet kyçe të demokracisë janë: toleranca, barazia para ligjit, e drejta për të votuar, garantimi i të drejtave të njeriut, liria e shprehjes, aktivizimi qytetar e kështu me radhë.



Në foto janë paraqitur autorët e artikullit

KUVENDI DHE MBLEDHJET E TIJ

BLEND (12), FLORID (12), ERZA (12), SUELA (11), SUMEA (12), ROMESA (12)

FUNKSIONET E KUVENDIT TË KOSOVËS



Ne jemi nxënësit e klasës së VI-1 nga shkolla fillore „Sadri Misini“ nga Shipashnica e Kamenicës

Në këtë artikull, ne kemi vendosur të shkruajmë për Kuvendin e Kosovës. Kuvendi i Kosovës është institucion demokratik, i zgjedhur nga populli. Aty bëhen mbledhjet apo seancat plenare. Këto seanca mbahen çdo ditë të enjte të javës. Kuvendi i Kosovës ka 120 deputetë. Nga ata, 100 janë shqiptarë, ndërsa 20 janë serbë, ashkalinjë, egjiptianë, turq, boshnjakë, romë, goranë. Fjala „Kuvend“ do të thotë kuvendoj ose bisedoj. Kuvendi ka dy gjuhë zyrtare: gjuhën shqipe dhe gjuhën serbe. Për këtë arsye punojnë edhe disa përkthyes. Ne sot mësuam për funksionet e Kuvendit të Kosovës, të cilat janë: funksioni përfaqësues, funksioni legjislativ dhe funksioni i kontrollit. Funksioni përfaqësues do të thotë se deputetët përfaqësojnë interesat e qytetarëve. Funksioni legjislativ do të thotë se deputetët duhet të bëjnë dhe të miratojnë ligjet e

Kosovës, të cilat duhet t'i respektojmë të gjithë. Në fund, kemi funksionin e kontrollit, i cili do të thotë se deputetët kanë për detyrë të kontrollojnë punën e Qeverisë. Kuvendi, po ashtu ka për detyrë të zgjedh Qeverinë, Presidentin si dhe zgjedh Kryetarin e Kuvendit. Kryetari ka për detyrë t'iu jap fjalën deputetëve dhe të mbajë rendin e ditës. Grupi ynë mendon se të jesh deputet është punë e vështirë, prandaj duhet të merret me shumë përgjegjësi. Deputetët duhet të jenë të drejtë, të dëgjojnë fjalën e popullit dhe t'i respektojnë të gjitha ligjet. Edhe ne, ashtu si deputetët e Kuvendit të Kosovës, bisedojmë në familje dhe mundohemi t'i zgjidhim problemet tona së bashku dhe asnjëherë të mos grindemi në mes vete. Kjo është demokracia e vërtetë. Aty ku të gjithë jemi të barabartë dhe jetojmë të lirë e të lumtur.



Këta jemi ne, autorët e artikullit



Vizatimi i Kuvendit të Kosovës


DEPUTETËT E KUVENDIT TË KOSOVËS

ARIELA (11), ALTIN (12), ALBINOTA (11), DONIK (11), ELION (11), ARTIZANA (12)

Nëse dikush nga lexuesit dëshiron të dijë për deputetët, atëherë ju lutem lexojeni artikullin tonë, të cilin e kemi përgatitur me shumë dashuri

Ne kemi një shok, i cili quhet Meriton. Ai sapo ka mbushur 25 vjet dhe dëshiron të bëhet deputet. Fillimisht ai duhet të shkojë te Komisioni Qendror Zgjedhor. Aty, për t'u bërë kandidat, duhet të hyj në listën e kandidatëve. Në ditën e zgjedhjeve, me votat e votuesve, ai mund të bëhet deputet dhe të punojë në Kuvendin e Kosovës.

Për t'u bërë deputet, kandidati duhet t'i ketë mbi 18 vjeç dhe duhet të bëjë fushatë, duke iu premtuar qytetarëve shumë gjëra. Pasi të bëhet deputet, ai duhet t'i mbaj ato premtime. Ne mendojmë se nëse ai nuk i mban premtimet, atëherë qytetarët nuk do ta votojnë në zgjedhjet e ardhshme. Ne i urojmë Meritonit fat në zgjedhjet e ardhshme dhe të bëhet deputet i mirë.



Kjo është Deklarata e Betimit të deputetëve



Ja si duket Kushtetuta jonë




Kandidati për deputet duke dhënë premtime qytetarëve



Qytetarët e Kosovës duke votuar për deputetët




Gazetarët që shkruajtëm këtë artikull



Konventa me të Drejtat e Fëmijëve



Duke votuar



Pema e të drejtave të fëmijëve



Gjatë aktivitetit në Punëtori



Duke vizatuar një kandidat për deputet



Duke i kryer detyrat grupore




Grupi i demokracisë



Gjatë punës në grup


VOTA ËSHTË E JONA

EMIR (11), ENKLEON (12), ALBION (11), HASAN (12), EROLL (11)



Ekziston një dallim mes procesit zgjedhor që ndodh në shtetet demokratike si dhe zgjedhjeve të përditshme. Mësojeni këtë në artikullin tonë

Ne anëtarët e grupit tonë, vendosëm që grupi ynë të mbajë emrin „Molla“. Këtë vendim e morëm duke votuar. Shumica e anëtarëve të grupit votuan për alternativën „Molla“. Andaj, u vendos që grupi ynë të quhet kështu. Në këtë rast, ne e treguam mendimin



tonë me anë të votës. Ishim të lirë të vendosim vet, prandaj edhe vota jonë ishte e lirë. Ky nuk ishte rasti i vetëm që ne kemi votuar. Kjo pasi që ne kemi votuar edhe në klasë, kur kemi vendosur se a duam të shkojmë në ekskursion apo jo. Zgjedhjet që i bëjmë në përditshmëri dallojnë nga procesi zgjedhor. Ne mund të zgjedhim një akullorë me shije të caktuar. Mirëpo, nëse akullorja nuk na pëlqen, ne thjesht e blejmë një akullorë me shije tjetër. Gjithsesi, procesi zgjedhor

është më i ndërlikuar se kaq. E dijmë se në procesin zgjedhor ne i zgjedhim përfaqësuesit tanë. Këta përfaqësues kanë për detyrë të udhëheqin vendin tonë. Prandaj, për të marrë pjesë në këtë proces, ne duhet të jemi mbi moshën 18 vjeçare. Kjo vlen për shkak se zgjedhja e përfaqësuesve nuk është aq e thjeshtë sa zgjedhja e një akullorëje. Nëse ne e zgjedhim një person jo të duhur për të qenë udhëheqës, normalisht duhet të presim 4 vjet deri në zgjedhjet e ardhshme për ta zëvendësuar me dikë tjetër.

Kemi dy lloje të zgjedhjeve: zgjedhjet parlamentare dhe zgjedhjet lokale. Në zgjedhjet parlamentare i zgjedhim deputetët, kurse në zgjedhjet lokale e zgjedhim kryetarin e komunave përkatëse. Vota e të gjithë neve ka vlerë shumë të madhe. Asnjëherë mos hezitoni të votoni. Të votosh do të thotë të shprehësh mendimin tënd. Të gjithë jemi të lirë ta bëjmë këtë, prandaj bëje edhe ti.



Autorët e artikullit

GJITHMONË AKTIV

ANESA (12), HANUMSHAHE (12), ORGES (11), DRINOR (12), ERZA (11)



Të gjithë ne jemi qytetarë të ndonjë shteti të caktuar. Jemi të lirë dhe kemi shumë të drejta. Jemi të barabartë dhe të lumtur në shtetin tonë demokratik. Mirëpo, ne duhet të jemi aktiv dhe të përgjegjshëm

Të gjithë ne jemi qytetarë të Kosovës. Ajo çka na bën neve qytetarë, është fakti se bëjmë pjesë në regjistrin civil, kemi leje qëndrimi dhe gëzojmë të drejtën e votës në vendin tonë. Pra, këto janë disa nga gjërat që të bëjnë ty qytetar të një vendi.

Kosova jonë është demokratike dhe ne si qytetarë të saj kemi të drejta. Këto të drejta i gëzojnë të gjithë, sepse demokracia na bën të gjithëve të barabartë. Kjo nënkupton se pavarësisht fesë, gjinisë, racës apo kombit, të gjithë i kemi të drejtat e barabarta. Disa nga të drejtat tona janë: e drejta e shkollimit, e drejta e lojës, e drejta e votës, etj.

Përpos që kemi të drejta, ne kemi edhe përgjegjësi. Përgjegjësitë tona si qytetarë janë: respektimi i ligjit,

respektimi i njëri-tjetrit, ruajtja e objekteve publike, mbrojtja e mjedisit, etj.

Mirëpo, nuk duhet harruar se ne nxënësit mund të jemi aktiv në vendin tonë. Ka disa mënyra që ne mund të jemi aktiv. Si për shembull, mund të jemi aktiv duke marrë pjesë në tubime të ndryshme, duke u bërë pjesë e procesit zgjedhor, duke qenë anëtarë të organizatave të ndryshme, që i mbrojnë të drejtat e njeriut apo fëmijëve, etj.

Përpos këtyre që i përmendëm, një mënyrë tjetër është edhe puna vullnetare. Edhe ne mund të bëjmë punë vullnetare, duke rregulluar oborrin e ndonjë shkolle që ka nevojë, ose duke mbjellur fidane në ndonjë park. Bëhuni edhe ju qytetarë aktiv, sikurse ne.



Ambienti i pastër, përgjegjësia jonë



Ne e respektojmë ligjin



IMPRESUM

demos  ti

Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga

TOKA

Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@toka-ks.org
Website: www.toka-ks.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Sadri Misini“
Klasa: VI
Vendi: Kamenicë